

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**  
**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A- 133/2013**

**Prishtinë,**

**4 gusht 2014**

Në çështjen juridike të:

**S. P. M.**

Nish, Serbi

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

**kundër**

**P. R.**

Prishtinë

Kosovë

**Pala përgjegjëse në kërkesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Dag Brathole, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPPC/D/C/176/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA34343), të datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 4 Gusht 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e palës ankuese S. P. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/176/2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34343, e datës 24 tetor 2012.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/176/2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34343, i datës 24 tetor 2012.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 9 maj 2007, paraqitësja e kërkesës S. P. M., si bashkëshorte e D. D. M. ka paraqitur një kërkesë duke kërkuar r-posedimin e lokalit afarist që ndodhet në adresën, rruga Vidovdanska 26 C, Prishtinë në ngastrën kadastrale nr. 6226 me sipërfaqe prej 69.1 m<sup>2</sup>.
2. Bashkë me kërkesën, ajo ka paraqitur, *inter alia*, kopjen e certifikatës së martesës të lëshuar me 27 mars 2008; lejen e vozitjes të datës 27 tetor 1992; një aktgjykim të datës 3 prill 1998 të Gjykatës Komunale në Nish (P.br.1240/98) dhe një kopje të “kontratës për shitblerje të një kapitali në pronësi shoqërore përmes ankandit publik” të datës 11 nëntor 2003 e lidhur në mes të Agjencisë së Privatizimit në Beograd dhe D. M.
3. AKP-ja e ka bërë njoftimin e pronës së kërkuar me 2 janar 2008.
4. P. R. ka paraqitur njoftim për pjesëmarrje në procedurë me 14 tetor 2008. Ai ka kërkuar të drejtën pronësore mbi lokalit afarist në fjalë. Përveç aktgjykimit të njëjtë të Gjykatës Komunale në Nish, të datës 3 prill 1998 në të cilin mbështetet edhe paraqitësja e kërkesës, ai ka paraqitur një kopje të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, ë datës 16 tetor 2006, me numër C.nr 77/2005; një kopje të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të lëshuar me 22 tetor 2008, me numër AC.nr.217/2007, që anulon aktgjykimin C.nr 77/2005 dhe që atë e kthen në Gjykatën Komunale, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të datës 23 shkurt 2009, me numër C.nr.2002/2008.
5. Më 24 tetor 2012, KKPK-ja, me vendimin KPCC/D/C/176/2012, ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. (në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-

079). Në arsyetimin e vet, KKPK-ja potencon se “bartësi i pretenduar i së drejtë pronësore ka bërë padi para 16 tetorit 2006 në gjykatën kompetente, ku ka kërkuar konfirmimin e të drejtës së tij pronësore mbi pronën e kërkuar.” Rrjedhimisht, KKPK-ja ka theksuar se juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse procedura gjyqësore lidhur me këtë kërkesë ka filluar para 16 tetorit 2006, data kur rregullorja e UNMIK-ut UNMIK/REG/2006/50 ka hyrë në fuqi.

6. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës me 2 prill 2013. Ajo ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi, përmes Zyrës së UNHCR, me 7 maj 2013.
7. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë R. P. më 6 nëntor 2013. Ai ka paraqitur përgjigje në ankesë më 22 nëntor 2013.

#### **Pretendimet e paraqitëses së kërkesës/palës ankuese**

8. Pala ankuese pretendon se bashkëshorti i saj është pronari i pjesës më të madhe të pronës së privatizuar - ndërmarrjes 22 dhjetori në Nish, dhe në këtë mënyrë edhe i lokalit afarist që ndodhet në Rrugën Vidovdanska 26 C, të cilin ai e kishte blerë me mjete vetanake.
9. Në ankesën e saj, ajo ka pretenduar se KKPK-ja ka marrë vendim të gabuar kur e ka hedhur poshtë kërkesën, për shkak të mungesës së juridiksionit. Ajo nuk e ka mohuar se e ka paraqitur një padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër palës përgjegjëse në kërkesë R. P. për ri-posedim-pronësi të lokalit të njëjtë në vitin 2005; megjithatë, ajo ka pohuar se pasi ajo procedurë ishte ende e pazgjidhur dhe meqë nuk kishte përfunduar, KKPK-ja është dashur ta kishte shqyrtuar kërkesën e saj.

#### **Pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë**

10. Pala përgjegjëse në kërkesë deklaron se lokali afarist i kërkuar që ndodhet në Rrugën Vidovdanska nr 26 C, me sipërfaqe prej 69.19 m<sup>2</sup>, në të kaluarën ishte pronë e ndërmarrjes 22 dhjetor me seli në Nish. Ai ka pohuar se lokali ishte blerë nga “R. Company” pronë e familjes R., në Prishtinë, e vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Nish, me numër P.nr. 1240/98, i datës 3 prill 1998.
11. Ai ka deklaruar se paraqitësja e kërkesës ka iniciuar procedurë gjyqësore në vitin 2005 në Gjykatën Komunale në Prishtinë për po të njëjtën çështje lëndore për kthimin e pronës. Ai në vazhdim ka deklaruar se Gjykata Komunale e ka refuzuar atë padi si të pabazuar, dhe e cila ishte prishur nga Gjykata e Qarkut dhe është kthyer në rishqyrtim. Ai ka përmendur se Gjykata Komunale edhe njëherë e ka refuzuar kërkesën më 22 tetor 2008 kundër së cilës është paraqitur një ankesë nga

paraqitësja e kërkesës. Për sa i përket statusit të procedurës së ankesës, ai është shprehur se është ende e pazgjidhur në Gjykatën e Apelit.

### Arsyetimi ligjor:

#### **Pranueshmëria e ankesës**

12. Gjykata Supreme ka juridiksion për ankesat kundër vendimit të KKPK-së.
13. Ankesa është paraqitur më 7 maj 2013, ndërsa vendimi i kundërshtuar i KKPK-së i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës më 2 prill 2013. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka skaduar më 2 maj 2013, e enjte. Sidoqoftë, pala ankuese ka paraqitur një dokument së bashku me ankesën, të lëshuar nga sh.a. M-Industry në Nish më 26 prill 2013, ku thuhet se me këtë vendim punëtorët kanë të drejtën e bashkimit të pushimeve të 1 majit dhe për pashkë, dhe se ndërmarrja do të jetë e mbyllur prej 29 prill 2013 deri më 6 maj 2013.
14. Gjykata Supreme ka gjetur se ankesa nuk është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh sikurse parashihet me ligj (neni 12.1 i Ligjit 03/L-079). Sipas nenin 7 të UA të UNMIK-ut 2007/5, afati vazhdohet vetëm deri në fund të ditës së parë të punës që pason nëse dita e fundit e afatit bie të shtunën, të dielën, apo në pushim zyrtar. Dita e fundit e paraqitjes së ankesës ka qenë 2 maji 2013, e enjte, që nuk ka qenë pushim zyrtar në Kosovë. Megjithatë, Gjykata Supreme merr parasysh faktin se pala ankuese banon në Serbi dhe se vendimi i atakuar po ashtu i është dërguar në Serbi. Ajo ka dorëzuar një dokument që tregonte se ka qenë pushim në Serbi deri më 7 maj 2013. Ajo e ka paraqitur ankesën pranë Zyrës së UHCR më 7 maj. Duke kontrolluar përmes internetit është gjetur se e tërë periudha nga data 1 maj, dita e punëtorëve, deri më 6 maj, pashkët ortodokse, kanë qenë të deklaruar si pushime zyrtare në Serbi. Rrjedhimisht, pala ankuese nuk ka pasur mundësi që ta paraqes ankesën pranë zyrës së UNCHR-së në shtetin ku banon, që duhet të merret në dobi të saj. Gjykata Supreme konsideron se në bazë të këtyre shkaqeve të arsyeshme, ankesa e saj është paraqitur me kohë dhe është e pranueshme.

#### **Meritat e ankesës**

15. KKPK-ja në vendimin e kundërshtuar ka hedhur poshtë kërkesën në mungesë të juridiksionin bazuar në faktin se nuk kishte filluar procedura para Gjykatës Komonale në Prishtinë para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 më 16 tetor 2006. Asnjëra palë nuk e ka mohuar ekzistimin e procedurës gjyqësore që kishte filluar në vitin 2005 ndërmjet këtyre palëve për të njëjtë

lëndë, duke kërkuar të drejtën pronësore dhe posedimin e lokalit afarist. Nuk kontestohet nga palët se ajo procedurë ende ishte e pazgjidhur në kohën e paraqitjes së kërkesës dhe të ankesës në fjalë. Megjithatë, për dallim nga pala përgjegjëse në kërkesë, pala ankuese pohon se KKPK-ja është dashur të vendos për kërkesën e saj mbi meritat pasi që gjykata e mëparshme nuk e kishte përfunduar shqyrtimin e kërkesës. Ky është kontestimi i vetëm i palës ankuese sa i përket vendimit të kundërshtuar.

16. Gjykata Supreme ka konkluduar se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë kur ka hedhur poshtë kërkesën e paraqitur në AKP për shkak të formulimi të qartë të nenit 18 të Ligjit nr. 03/L-079. Pasi që paraqitësja e kërkesës veçse kishte filluar procedurën gjyqësore kundër personit të njëjtë për të njëjtën lëndë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, mbi të cilën Gjykata e cekur kishte vendosur dy herë se Aktgjykimet e kujt ishin kundërshtuar, Ligji nr. 03/L-079 shprehimisht përjashton zbatimin e Ligjit të cekur mbi çështjen në fjalë, dhe rrjedhimisht përjashton juridiksionin e KKPK-së. Fakti se ajo procedurë nuk ishte përfunduar ende nuk është arsye që të merret juridiksioni i KKPK-së. Megjithatë, kërkesa e dytë e paraqitur pranë KKPK-së për të njëjtën lëndë në çdo situatë do të shkaktonte *litis pendance* ku do të kërkohej që e njëjta të hidhet poshtë.
17. Vendimi i KKPK-së nuk përmban ndonjë gabim thelbësore apo zbatim të gabuar të së drejtës procedural dhe materiale në fuqi, apo vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve. Prandaj, ankesa e palës ankuese refuzohet si e pabazuar në përputhje me nenin 13.3(c) të Ligjit nr. L/03-79 dhe vërtetohet vendimi i KKPK-së.
18. Ky aktgjykim është pa paragjykim ndaj rezultatit të procedurës së pazgjidhur para Gjykatës së Apelit apo në çdo gjykatë kompetente për ta shqyrtuar një kërkesë të tillë.
19. Bazuar në të mësipërmen dhe në pajtueshmëri me nenin 12.2 të Ligjit 03/L-079 dhe nenin 195.1 (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Esmá Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it**

**Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**